



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 24.24.1-2017-08

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE
TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS PËR VITIN E
PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017**

Prishtinë, qershor 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Burbuqe Idrizi (udhëheqëse ekipi) dhe Shpresa Zenelaj (anëtare e ekipit), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit, Ramadan Gashi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	10
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	15
5 Qeverisja e mirë.....	16
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	18
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme	21
Shtojca III: Letërkonfirmimi	22

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 19/10/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm


Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Përgjigjja e Sekretarit të Përgjithshëm - auditimi 2017

Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuar dhe konkluzionet e auditimit, dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. Ne kemi analizuar veprimtarinë e organizatës se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e AP-së.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Ne kemi audituar PFV-të e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës (GJKK-së) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, rr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Zyrtari kryesor financiar i GJKK-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Sekretari i Përgjithshëm i GJKK-së është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të GJKK-së.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

GJKK-së i kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Pasqyrat Nëntëmujore me kohë;
- Planin e Prokurimit për vitin 2017; dhe
- PVF janë përgatitur me kohë dhe nënshkruar nga ZKA dhe ZKF.

Në kontekst të cilësisë së PFV-ve, dhe kërkesave për raportim të jashtëm, ne nuk kemi identifikuar ndonjë parregullsi.

DEKLARATA E BËRË NGA MENAXHMENTI I GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, është e saktë për shkak se gjatë auditimit nuk janë identifikuar gabime materiale.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Nuk kemi rekomandime lidhur me PFV-të.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Menaxhimi financiar dhe kontrolli efektiv kërkojnë procese të rishikimit dhe udhëzues përcjellës të cilët sigurojnë zbatimin e plotë të ligjeve, rregulloreve të brendshme dhe proceseve të tjera të kontrollit, që në përgjithësi GJKK ka kontrollë të duhura në raport me obligimet e saj ligjore. Megjithatë, menaxhimi i pasurisë mbetet fushë sfiduese.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	1,541,513	1,540,970	1,527,569	1,445,956	1,406,124
Granti i Qeverisë -Buxheti	1,541,513	1,518,513	1,505,146	1,445,956	1,406,124
Donacionet e jashtme - Qeveria Turke	-	22,457	22,423	-	-

Buxheti final në raport me atë fillestar ishte zvogëluar për 543€. Kjo diferencë është si rezultat i reduktimit të grantit qeveritar për 23,000€ me rishikim të buxhetit, si dhe rritjes nga donacionet e jashtme për 22,457€.

GJKK ka pranuar grante nga donatorët e jashtëm (Qeveria Turke) në vlerën prej 22,457€, i cili ishte shpenzuar në tërësi për qëllime të udhëtimeve zyrtare jashtë vendit.

Në vitin 2017, GJKK ka shpenzuar 1,527,569€ apo 99% të buxhetit final, me një nivel të ngjashëm me vitin 2016.

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	1,541,513	1,540,970	1,527,569	1,445,955	1,406,124
Pagat dhe Mëditjet	1,022,548	999,548	998,706	955,388	917,678
Mallrat dhe Shërbimet	489,965	512,422	500,301	485,537	485,328
Shërbimet komunale	4,000	4,000	3,562	2,498	3,118
Investimet Kapitale	25,000	25,000	25,000	2,532	-

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje ishte zvogëluar për 23,000€ me rishikim të buxhetit. Realizimi i buxhetit final për këtë kategori ishte 100%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 22,457€ nga donacionet e jashtme. Realizimi i buxhetit final për këtë kategori ishte 98%;
- Buxheti final për investime kapitale nuk kishte ndryshim nga ai fillestar dhe se si i tillë ishte realizuar në tërësi. Me këtë buxhet ishte paguar blerja e një veture.

3.2 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave (payrollit) që menaxhohet nga MAP dhe MF. Kontrollat kyçe që e konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave janë listat e pagave të nënshkruara nga udhëheqësit e njësive organizative. Ne testuam pajtueshmërinë e listave të pagave me sistemin e pagave punëtorët aktual, largimet, pushimet e lehonave dhe pensionet. Po ashtu, kemi rishikuar nëse punonjësit janë paguar sipas kontratës.

Çështjet e identifikuar në fazën e ndërmjetme² pas rekomandimeve tona ishin përmirësuar në fazën finale. Megjithatë nga mostrat e testuar ne kemi identifikuar pagesa të parregullta të rastet e shfrytëzimit të pushimit të lehonisë, çështja si në vijim:

² Shtesat e aplikuara nga gjykata jo në harmoni me vendimet përkatëse, si dhe aplikimi i shtesës së SHCK-së për të punësuarit të cilët nuk e kanë statusin e shërbyesve civil.

Çështja 1 - Kompensimi i shtesave gjatë pushimit të lehonisë

E gjetura Në GJKK gjatë vitit 2017 ishin tri kërkesa për shfrytëzimin e pushimit të lehonisë.

Ligji i punës, neni 49, përcakton se gjashtë muajt e parë të pushimit të lehonisë, nëpunësja paguhet nga institucioni me kompensim 70% të pagës bazë. Ne kemi identifikuar se një e punësuar gjatë shfrytëzimit të pushimit të lehonisë ishte paguar më tepër që i takon me ligj për 1,135€. Kjo si rezultat që të punësuarës ju kishte përlllogaritur shtesa e aplikueshme në GJKK për pozitën Sekretare Ligjore.

Rastet e njëjta ishin edhe kompensimi i dy të punësuarave tjera në pushim të lehonisë (nga muaji nëntor 2017) të cilave ju kishte kompensuar edhe shtesa e aplikuar nga gjykata (5% e pagës bazë).

Sipas kalkulimit të bërë nga ne, buxheti i GJKK-së nga aplikimi i këtyre shtesave është mbi-shpenzuar për 1,245€.

Rreziku Mos ndalesa e shtesave gjatë pushimit të lehonisë dhe pagesat e tilla jo në përputhje me vendimet e GJKK-së dhe ligjet në fuqi, rrezikojnë që me rastin e kompensimit të lehonave të dëmtohet buxheti i GJKK-së.

Rekomandimi 1 Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj vendosjen kontrolleve të shtuara për të parandaluar gabimet e identifikuar në mënyrë që rastet e tilla të mos përsëriten. Pagesat e kryera ndaj lehonave duhet të jenë në harmoni të plotë me kërkesat ligjore dhe vendimet përkatëse të GJKK-së.

3.3 Menaxhimi i personelit

Menaxhimi i personelit përfshin të gjitha veprimet që ndërlidhen me rekrutimin, kontratat, trajnimet, avancimin, pushimet etj. Ne kemi testuar një numër mostrash për të siguruar se veprimet e ndërmarra në këtë fushë janë në harmoni me rregulloret e zbatueshme.

Në GJKK numri i aprovuar i stafit për vitin 2017 ishte 66 pozita dhe deri në fund të vitit 2017 ishin 65 të punësuar dhe një pozitë e lirë e cila ishte e rezervuar për gjyqtarë për të cilën ishin në procedurë të përzgjedhjes nga Kuvendi i Kosovës. Në mostrat e testuara nuk kemi vërejtur ndonjë çështje për t'u raportuar.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

3.4 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për kategorinë e mallra dhe shërbime dhe shërbimet komunale ishte 516,422€. Prej tyre ishin shpenzuar 503,863€. Pjesa më e madhe e shpenzimeve në këto kategori përfshijnë shpenzimet e udhëtimeve zyrtare, furnizim për zyrë dhe shpenzimet për shërbime të ndryshme intelektuale. Në mostrat e testuara nuk kemi vërejtur ndonjë çështje për t'u raportuar.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

3.5 Investimet kapitale

Buxheti final dhe i shpenzuar për investime kapitale ishte 25,000€. Shpenzimet ishte bërë për blerjen e veturës zyrtare për GJKK-në.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

3.6 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi i pasurisë është një pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Një menaxhim i mirë i pasurive kërkon përcaktim të qartë të rrjedhjes së detyrave për regjistrimin, krahasimin, raportimin dhe shpalosjen e tyre në PFV.

GJKK në PVF kishte shpalosur pasurinë kapitale mbi 1,000€ në vlerë 107,865€, ndërsa pasuria jo-kapitale nën 1,000€ në vlerë 47,787€.

Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit dhe mënyra e mbajtjes së evidencës është në pajtueshmëri me kërkesat e Rregullores MF nr. 02/2013, për menaxhimin e pasurisë jo-financiare të organizatave buxhetore. Auditimi ynë mbi menaxhimin e pasurisë identifikoi dobësitë e paraqitura më poshtë:

Çështja 2 – Regjistër jo i saktë i pasurive jo-financiare

E gjetura Neni 6 i rregullores nr.02/2013 përcakton se pasuritë kapitale duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël-SIMFK, ndërsa pasuritë jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria. GJKK e përdor sistemin e -pasuria, mirëpo ne kemi vërejtur që ky regjistër nuk është i saktë, pasi që për të gjitha pasuritë e regjistruara në këtë regjistër nuk është aplikuar zhvlerësimi (përveç pasurisë së regjistruar në vitin 2016). Kësisoj vlera neto është e barabartë me vlerën origjinale të pasurive³. Megjithatë GJKK në PVF-të e vitit 2017 kishte prezantuar pasuritë jo kapitale në vlerë 47,787€ në bazë të kalkulimeve të brendshme (në forma tabelare në Excel). Edhe pse nga testimet tona, ne nuk kemi vërejtur gabime të normat e zhvlerësimit tek regjistri i brendshëm, mirëpo kalkulimet bëhen në mënyrë manuale. Kësisoj, ne nuk mund të marrim siguri për aplikimin e normave të drejta të zhvlerësimit për të gjitha pasurit nën 1,000€.

Po ashtu, ne kemi vërejtur që në tri raste⁴ në regjistrin e SIMFK janë të regjistruara si pasuri kapitale vlera totale e faturave, ndërsa individualisht ishin asete me pak se 1,000€, dhe të njëjtat figurojnë edhe në regjistrin e e-pasurisë. Si rrjedhojë e kësaj, në një rast pagesa e realizuar në vitin 2012 për furnizim me telefona në vlerë totale 9,950€, ishte regjistruar në regjistrin e SIMFK-së si pasuri kapitale (15 telefona mobil me vlerë 665€ për njësi), dhe si e tillë nga sistemi është ndryshuar norma e zhvlerësimit nga 3 në 8⁵ vite. Kjo ka rezultuar me mbivlerësim të pasurisë për 2,798€.

Rreziku Mos funksionimi i plotë i sistemit e-pasuria në përputhje me kërkesat e rregullores nr.02/2013, aplikimi në mënyrë manuale i normave të zhvlerësimit, rrit rrezikun e gabimeve në kalkulim që mund të rezultojnë me mbi/nënvlerësimin e pasurisë jokatitale në PFV. Po ashtu regjistrimet e dyfishta, nuk na ofrojnë siguri se regjistri i pasurisë është i plotë dhe i saktë.

Rekomandimi 2 Sekretari i Përgjithshëm duhet të bëjë përpjekje që në bashkëpunim me MAP-in të funksionalizohet në mënyrë të plotë sistemi e-pasuria për të mundësuar gjenerimin e raporteve të sakta të pasurisë jo kapitale. Njëkohësisht, të forcoj kontrollet në menaxhimin e pasurisë, duke bërë regjistrimet në kodet e duhura të pasurive në mënyrë që të aplikohen normat e sakta të zhvlerësimit.

³ Vlera neto në total e pasurive jo kapitale ne sistemin e-pasuria është 958,569€.

⁴ Furnizim me mobilje (4,320€), furnizim me pajisje te IT (10,598€), furnizim me telefona (9,950€).

⁵ Sipas Rregullores 02/2013, neni 22 paragrafi 4.18 norma zhvlerësimit për telefona mobil është 3 vite, ndërsa paragrafi 4.17 norma zhvlerësimit për telefona fiks është 8 vite.

3.7 Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj

Paraja e gatshme ishte menaxhuar në harmoni me rregullën 01/2013 për shpenzimin e parave publike. Të gjitha transaksionet e parave të imëta ishin regjistruar në llogarinë përkatëse me rastin e arsyetimit të shpenzimeve të bëra nga fondi i parave të imëta.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

3.8 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 6,682€. Këto detyrime ishin paguar në janar të vitit 2018. GJKK ka një sistem të mirë kontrolli për menaxhimin e pagesave dhe raportimi i obligimeve ishte bërë në baza të rregullta mujore në Thesar.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2016 të GJKK-së ka rezultuar në dy rekomandime. GJKK kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna nga ZKA.

Dy rekomandimet e dhëna për vitin 2016 ishin zbatuar, ndërsa nga viti 2015 nuk ishte bartur asnjë rekomandim. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë përfshinë parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimit të rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat i dorëzohen MF-së.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërme.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Qeverisja në GJKK në fushën e raportimit menaxherial dhe llogaridhënies, pasqyron një situatë pozitive. GJKK ka zbatuar të gjitha rekomandimet e dhëna, si dhe kishte zbatuar kërkesat e MFK-së në hartimin e regjistrit të rreziqeve dhe plotësimin e listës kontrolluese të vetvlerësimit dhe dërgimin në MF. Pyetësi i vet-vlerësimit i GJKK-së pasqyron gjendjen aktuale dhe kishte dhënë përgjigje korrekte në shumicën e pyetjeve të parashtruara, të bazuara në dëshmi/ veprime konkrete.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

GJKK ka një sistem funksional të auditimit të brendshëm si segment i rëndësishëm për të siguruar menaxhmentin e lartë se mekanizmat e kontrollit të brendshëm janë dizajnuar dhe zbatohen në mënyrën e duhur. Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) përbëhet nga një auditor (Drejtori i NJAB) i cili kishte të aprovuar planin vjetor dhe strategjik. NJAB për vitin 2017 kishte planifikuar dhe kryer pesë auditime të rregullta.

Raportet e përfunduara të NJAB, si fokus kishin rishikimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në GJKK, si dhe përcjellja e implementimit të rekomandimeve. Vlerësimi ynë është se raportet e NJAB janë cilësore dhe menaxhmentit i kishin ofruar pasqyrë të qartë mbi nivelin e efikasitetit dhe efektivitetit të operimit të kontrolleve të brendshme.

GJKK ka të themeluar komitetin e auditimit. Ky komitet deri në fund të vitit 2017 ishte takuar katër herë për të shqyrtuar raportet e AB, duke nxjerrur konkluzione për menaxhmentin.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara. Procesi i raportimit të brendshëm funksionon sipas zingjirit llogaridhënës në përputhje me ligjin dhe strukturën organizative. Lidhur me këtë, menaxhmenti mban takime të rregullta me të gjitha departamentet dhe njësitë e saj, çështjet e diskutuara dhe konkluzionet e takimeve ishin pasqyruar në procesverbalet e rregullta.

GJKK ka hartuar regjistrin e rreziqeve duke i identifikuar rreziqet domethënëse që mund të kenë ndikim në arritjen e objektivave. Ky regjistër ishte menaxhuar dhe monitoruar në mënyrë sistematike, si dhe kishte ndërmarrur veprime për të zbutur rreziqet e identifikuara në mënyrë që të mos kenë ndikim negativ në realizimin objektivave të përcaktuara.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme

Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
3.1.2 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj se në raste të zëvendësimit të përkohshëm të nëpunësve të përhershëm civilë apo mbingarkesave në punë, te aplikohen procedurat e përcaktuara në bazë të LShC-së.	Rekomandimi është zbatuar.		
3.2 Pasuritë	Sekretari i Përgjithshëm duhet të forcoj kontrollet në menaxhimin e pasurisë, duke formuar komisionin për vlerësim të pasurive në mënyrë që të siguroj informata të drejta dhe të sakta për pasurinë që posedojnë.	Rekomandimi është zbatuar.		

Shtojca III: Letërkonfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE / DATUM: 12.06.2018			
Org. / Org. / Org. / Org.	Shkronjë / Class. / Class. / Class.	Nr. Prot. / Doc. No.	Nr. i Serisë / Ser. No.
05	400	1022	1

REPUBLIKA E KOSOVËS – РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE

УСТАВНИ СУД

CONSTITUTIONAL COURT

SEKRETARIA / SEKRETARIJAT / SECRETARIAT

Prishtinë, më 11 qershor 2018
Nr. Ref. : SP- 949/18/mv

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për periudhën 01.01.2017 deri më 31.12.2017 dhe për implementimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit (Pasqyrave) Financiar të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, për periudhën 01.01.2017 deri më 31.12.2017, (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- Pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj planin e veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre, (rekomandimet e paraqitura në draft raport të Zyrës Kombëtare të Auditimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese vetëm janë në fazën e implementimit).

Me respekt,


 Milot Vokshi

Sekretar i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës

Perandori Justinian 44., 10000 Prishtinë/a, Kosovë/o
Tel: +381 (0)38 606 162; Fax: +381 (0)38 606 170; www.gjk-ks.org